



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.443/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, dhe subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Komuna Prishtinë parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike në objekte fetare për qëllime elektorale të subjektit politik LVV, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.02.2025, mori këtë :

**V E N D I M**

**REFUZOHEN** të pabazuara ankesat Anr.443/2025 datë 07.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, dhe ankesa Anr.446/2025 datë 07.02.2025 parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, me pretendimin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, ka mbajtur tubim publik në objekte fetare.

**A r s y e t i m**

Me datë 07.02.2025 PZAP ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.443/2025 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, dhe Anr.446/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesën Anr.443/2025, pretendohet se subjekti politik LDK, aktivistët nga Dega Podujevë, me datë 06.02.2025 kanë verejtur se subjekti politik LVV me rastin e mbajtjes së tubimit politik elektorale në objekt fetar-xhami ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të Rregullores Zgjedhore 07/2024. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se duke u bazuar në këto prova ka kërkuar që të shqiptohet masë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV. Rast precedent për vendimmarrje janë vendimet A.nr.311/2025, dhe A.nr.369/2025, dhe çdo vendim ndryshe do të nënkuptonte standard të dyfishtë apo trajtim jo të barabartë të subjekteve politike.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur postimin e Lëvizjes Vetëvendosje-Qendra Besianë.

-Në ankesën Anr.446/2025, pretendohet se më datë 6 shkurt 2025, në ora 18:59/h, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z.Ejup Maqedonci, ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, në ambientet e brendshme të Xhamisë në Fshatin Majac, në të cilën ka mbajtur tubim për fushatë zgjedhore, me qëllim të përfitimit të votave. Sipas parashtruesit të ankesës, në këtë mënyrë, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ka publikuar fotografi në rrjetin e tij social Facebook me kategoritë të organizatave fetare, respektivisht në ambientet dhe të punësuarit në Bashkësinë Islame në fshatin Majac. Nga PZAP ka kërkuar që të merrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Si provë ka bashkangjitur postimin e shpërndarë nga kandidati Ejup Maqedonci në rrjetin e social Facebook, kjo foto është publikuar më datë 29 janar 2025, në ora 18:54 <https://www.facebook.com/ejup.maqedonci/posts>.

Më datë 08.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesat e parashtruara kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 08.02.2025 në ora 18:30.

-Në përgjigjen në ankesën Anr.443/2025, subjekti politik LVV e kundërshton pretendimin e subjektit politik LDK, me arsyetimin se nga fotot e bashkangjitura në ankesë nga subjekti politik LDK vërtetohet se njoftimi, dhe ftesa qytetarëve për tubim nga LVV është bërë për takim në odën e fshatit Majac, dhe jo në xhaminë e fshatit, andaj janë të pa bazuara pretendimet e palëve kundërshtare sepse takimi me qytetarë si në foton e bashkangjitur të ankesës është mbajtur në odën e fshatit, dhe jo në objekt kulti sikurse pretendojnë palët kundërshtare.

-Në përgjigjen në ankesën Anr.446/2025, subjekti politik LVV e kundërshton pretendimin e subjektit politik PDK, në të cilën ka theksuar se PZAP ka vlerësuar drejtë njëherë këtë gjendje faktike për kryeministrin në fjalë dhe të njëjtit nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin e shkeljes në të ardhmen, çka këtë çështje e bën të gjykuar, dhe ankesën të pas afatshme. Gjithashtu ka theksuar se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se z. Albin Kurti nuk ka përsëritur ngjarjen ashtu siç pretendohet dhe për të njëjtën ngjarje njëherë është dënuar (res judicata). Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se, arsyetimi se shkelja vazhdon të prodhojë efekt nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur sepse kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zbehte rolin e procedurës e cila ka nxjerrë njëherë vendim dhe përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që të refuzohet ankesa e palës parashtruese.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: Anr.443/2025, dhe Anr.446/2025 datë 07.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.443/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjektet politike LDK, dhe PDK kundër

subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e parashtruara të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se :

**-Ankesat janë të pabazuara.**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik LVV, është përdorur ndonjë objekt fetar për fushatë zgjedhore.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehen vetëm se është realizuar një tubim nga ana e subjektit politik LVV, në të cilin tubim kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të kjuartë dhe bindëse se ndonjë tubim është mbajtur në objekt fetar gjegjësisht në xhamin e fshatit ashtu siç pretendohet nga pala ankuuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë nuk mund të vërehet asnjë shenjë –simbole fetare apo ndonjë element i objektit fetar-xhamisë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Anr.443/2025 datë 10.02.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.